

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE  
AGJENCIA KOMBËTARE E AFTËSIVE DHE PUNËSIMIT  
SHKOLLA E MËSME PROFESIONALE "MIHAL SHAHINI" CERRIK

Nr 552 Prot

Cerrik me 26. 09 2023

Lënda : Njoftim për lëvizje paralele

Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun

Agjencisë kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Në zbatim të Ligjit nr 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", të Ligjit 15/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 554, datë 31.07.2019 "Për krijimin ,mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive ", të Udhëzimit Nr 14 , datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit profesional si dhe aspekte të menaxhimit të burimeve , përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit" ,

**Shkolla e mesme profesionale "Mihal Shahini", Cerrik** , njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

I. (një) Mësues të teorisë profesionale në drejtimin Bujqësi

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti për mësues të teorisë profesionale duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti për mësimdhënës të teorisë profesionale duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së
- b) të ketë të paktën 1 (vit) përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

## 2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- Letërmotivimin për pozicionin
- Jetëshkrimin (CV-në)
- Kartën e identitetit
- Diplomën
- Librezën e punës
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV
- Certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit
- Vërtetimin e gjendjes shëndetësore
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

## 3. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

## 4. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së . brenda datës

05.10.2023.

Drejtori i shkollës

ERINA DISHO

